

26.04.2017



70/4
26.04.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	26.04.2017
REFERENC-Ë:	70/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.180 të dt.21.04.2017 për lëndën Newko (Kompania e Re) nr. 04-353/01-24084.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.



240 04.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 25/2017
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi me vërejtje, i kërkesës/ projektit për renovimin të brendshëm dhe të jashtë të objektit, në ngastren kadastrle me nr. 2088 – 0 – 74 – 0 – 2 – 0, me kusht që, intervenimet të jenë në harmoni me Ligjin 04/L – 066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Planit të Konservimit – Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

New Co (Kompania e re) nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për renovimin e brendshëm dhe të jashtëm të objektit në ngastrën kadastrale me Nr. 2088 – 0 – 74 – 0 – 2 – 0. Objekti i lartë cekur gjendet në Zonën e II^{te} (zona e bllokut të objekteve të larta). Në afërsi të parcelës për ndërtim, nuk ka ndonjë objekt që është në lsitën e MKRS “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti gjendet në Rrugën “Sheshi i Lidhjes” P.N. Nga komisioni kërkohet vlerësimi i intervenimeve të parapara.

Sipas Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, nenit 6 (paragrafi 1.2) nuk lejohet vendosja e kiosqeve dhe elementeve tjera montazhë që do të pengonin vizurat dhe qasjen e lirshme në monument, dhe komisioni vlerëson se aneksi dhe tenda, e propozuar me projekt, pengojnë vizurat. Intervenimet në objektet ekzistuese, rekomandohet të bëhen me materiale të ngjashme me origjinalen, dhe është e ndaluar që muret e jashtme të vishen me pllaka (qeramike, terakotës, etj) pllaka të lustruara guri, llaç sintetik, alumin, plastikë, xham reflektues, xham i ngjyrosur. Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Aprovohet kërkesa e New Co (Kompania e re) për renovimin e mbrendshëm dhe të jashtëm të objektit në ngastrën kadastrale me nr. 2088 – 0 – 74 – 0 – 2 – 0, me kusht që, intervenimet të jenë në harmoni me Ligjin 04/L – 066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Planit të Konservimit.

2. Komisioni kërkon të punohet projekti kryesor në bazë të projektit ideor, propozimit faqe 9-të, të miratuar në Komision, me kusht që:

2.1.Reklama e paraparë të vendoset me projekt të mos jetë më e madhe se 1m², siç edhe është përcaktuar me ligjin për qendrën historike të Prizrenit

2.2.Në fasadë të mos përdoret alumini i anodizuar me natyrore apo ngjyrë ari.

3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në)

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri
U.D. Drejtor

